



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E LIPJANIT

REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 22-të të KPF-së të KK së Lipjanit mbajtur, më 20.12.2023, në sallën numër 1, kati i 3-të, me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezantuan:

1. Daut Azemi, Kryesues
2. Xhyla Dedushaj-Rexhepi, anëtare
3. Fitim Shala, anëtar
4. Albiona Tasholli, anëtare
5. Arsim Jashari, anëtar
6. Egzona Bytyqi, anëtare
7. Alban Salihu, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Anila Reqica-LLugiqi, DKRS
2. Rasim Hasani, DKA
3. Shkelzen Hajdini, DSHPS

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti *Behar Aliu*.

Kryesuesi i KPF-së Daut Azemi, pasi përshëndeti të pranishmit tha se pari ia uroj festa e nëntorit pastaj tha se rendin e ditës e keni marrë me kohë, dhe e lexoi në vazhdim.

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 21-të e Kuvendit.
2. Propozim Vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Çerdhes në Magure
3. Propozim Vendim për miratimin e planit të punës të ekipit për të drejtat e fëmijëve (2024-2026) për Komunën e Lipjanit
4. Propozim Vendim për miratimin e planit të veprimit për transparencë të komunës së Lipjanit 2023-2027

Pastaj tha do ta keni edhe një pikë shtesë me propozim të ekzekutivit

5. Propozim vendim për shfuqizimin e vendimit 15Nr.016/01-67386 i datës 22.12.2023 për miratimin e planit komunal për integritet 2023-2026

Meqë vërejtje nuk pati, Kryesuesi vuri në votim rendin e ditës me pikë shtesë dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja unanimisht me 7 vota për Aprovoi rendin e ditës:

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 20-të e KPF-së

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktin të cilin e keni marrë?

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë vërejtje nuk pati, Kryesuesi vuri në votim ekstraktin dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja unanimisht me 7 vota për Aprovoi Ekstraktin nga mbledhja e 20-të të KPF-së

Pastaj Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi, tha se vazhdojmë me pikat tjera të rendit të ditës.

II

Propozim Vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Çerdhes në Magure

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Rasim Hasani, nga DKA i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se kjo pune me ketë është paradoksale dhe nuk po e kuptoj pse ka pas me ardh diçka etil nga niveli qendror kur dihet qe ajo i takon shkollës dhe çerdhja do te vendoset afër shkollës, Po ne e përkrahim si propozim vendim.

Meqë diskutime tjera nuk pati, Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 7 vota për vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

III

Propozim Vendim për miratimin e planit të punës të ekipit për të drejtat e fëmijëve (2024-2026) për Komunën e Lipjanit

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Shkelzen Hajdinit nga DSHPS i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Propozimi

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se është një plan i mire vetëm po e dua një sqarim a ka me qen plan 3 vjeçar a po 2 vjeçar pasi qe ne propozim është 2024-2026. Dhe e a do te votohen prape tani si plan pas vitin 2026

Shkelzen Hajdini, tha se është plan 3 vjeçar. Po do te votohet prape tani pas vitin 2026

Meqë diskutime nuk pati, Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 7 vota për vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

IV

Propozim Vendim për miratimin e planit te veprimi për transparence i komunës se Lipjanit 2023-2027

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Anila Recica-LLuguqi nga DKRS e cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se unë mendoj qe këtu ka burokraci nga niveli qendror pasi qe dihet qe janë 11 ligje qe e rregullojnë këtë pune dhe nuk ka nevojë për diçka te tille.

Meqë diskutime tjera nuk pati, Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 7 vota për vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

V

Propozim vendim për shfuqizimin e vendimit 15Nr.016/01-67386 i datës 22.12.2023 për miratimin e planit komunal për integritet 2023-2026

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Anila Recica-LLuguqi nga DKRS e cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë diskutime nuk pati, Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 7 vota për vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

Meqë çështje tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 10:55

Ekstraktin e hartoi

Behar Aliu

Kryesuesi i Komitetit

Daut Azemi